



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo-Republic of Kosovo**  
*Kuvendi - Skupština – Assembly*

---

**Legjislatura VIII**  
**Sesioni pranveror**

**PËR:     Deputetët e Kuvendit**  
**Cc:     Kryesinë e Kuvendit**

**NGA:     Komisioni për Buxhet, Punë dhe Transfere**

**LËNDA: Raport me rekomandim, në lidhje me Projektligjin nr.08/L-139 për Ratifikimin e Marrëveshjes së Kredisë ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Bankës Evropiane për Investime për Projektin e zhvillimit të impiantit të ujërave të zeza në Mitrovicë**

**Datë: 06.04.2022**

---

Komisioni për Buxhet, Punë dhe Transfere, në bazë të nenit 60 dhe nenit 69, paragrafi 5 të Rregullores së Kuvendit, në mbledhjen e mbajtur më 06.04.2022, shqyrtoi Projektligjin nr. 08/L-139 për Ratifikimin e Marrëveshjes së Kredisë ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Bankës Evropiane për Investime për projektin e zhvillimit të impiantit të ujërave të zeza në Mitrovicë dhe vendosi që Kuvendit t’ia paraqesë këtë:

**R e k o m a n d i m**

1. Të miratohet Projektligjin nr.08/L-139 për Ratifikimin e Marrëveshjes së Kredisë ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Bankës Evropiane për Investime për projektin e zhvillimit të impiantit të ujërave të zeza në Mitrovicë.
2. Arsyetimin e raportit me rekomandime e paraqet deputeti, Armend Muja, kryetar i komisionit.

**Arsyetim**

Në bazë të nenit 10, paragrafit 1.4 dhe 2 të Ligjit nr. 04/L-052 për Marrëveshjet Ndërkombëtare, Kuvendi i Republikës së Kosovës, me votat e dy të tretave të të gjithë deputetëve, me ligj Ratifikon Marrëveshjet Ndërkombëtare për marrjen e obligimeve financiare nga Republika e Kosovës.

Komisioni për Buxhet, Punë dhe Transfere, në mbledhjen e mbajtur më 06.04.2022, pasi shqyrtoi Projektligjin nr. 08/L-139 për Ratifikimin e Marrëveshjes së Kredisë ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Bankës Evropiane për Investime për projektin e zhvillimit të impiantit të ujërave të zeza në Mitrovicë, vlerësoi se Ratifikimi i Marrëveshjes objektiv

kryesor ka ndërtimin e një rrjeti të integruar të kanalizimeve me zëvendësimin dhe riparimin e kanalizimeve të zgjedhura dhe ndërtimin e kanalizimeve të transferimit në vendin e Ujësjetës të propozuar. Kjo marrëveshje do të ndihmonte në përmirësimin e cilësisë së ujit dhe parandalimin e degradimit të burimeve mjedisore në rrjedhën e poshtme. Projekti do të përfshijë dy financues: Bankën Evropiane për Investime dhe Bankën Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim, andaj Komisioni i rekomandon Kuvendit Ratifikimin e kësaj marrëveshje.

**Kryetari i Komisionit,  
Armend Muja**